

Vendim nr. 237 datë 16.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Marjana Semini	Anëtare

në datën 16.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 22 (E) 2024 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ERMAL ALLA

OBJEKTI: Shfuqizimi i nenit 5 të ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999 “Statusi i deputetit”, i ndryshuar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 50, pika 4, 52, pika 2 dhe 71, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Ligji nr. 8550, datë 18.11.1999 “Statusi i deputetit”, i ndryshuar (*ligji nr. 8550/1999*), ka për objekt të drejtat e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë gjatë ushtrimit të detyrës. Marrëdhëniet

juridike të tij parashikohen në kreun I të ligjit. Në nenin 5 parashikohet se deputeti takohet periodikisht me zgjedhësit ose kur e kërkojnë ata. Deputeti i përfaqëson ata duke iu marrë mendime ose duke iu dhënë shpjegime për projektligje, amendamente, vendime, rezoluta apo deklarata që shqyrtohen dhe miratohen në Kuvend. Në kreun II të ligjit parashikohen marrëdhëniet me organet shtetërore qendrore dhe vendore. Neni 12 i ligjit parashikon se deputeti, kur konstaton se nëpunës të emëruar të administratës shtetërore publike shkelin ligjet, ka të drejtë të kërkojë pranë organit përkatës marrjen e masave në përputhje me legjislacionin përkatës. Titullarët e këtyre organeve janë të detyruar të shqyrtojnë menjëherë propozimet e bëra dhe brenda 30 ditëve të marrin vendimin përkatës, duke njoftuar deputetin.

2. Kërkuesi Ermal Alla (*kërkuesi*), në datën 12.02.2024, ka paraqitur një kërkesë pranë Kryetares së Kuvendit në lidhje me problematikën që ai ka me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) për anulimin e procedurës së regjistrimit të aktit noterial të datës 30.04.2001. Sipas tij, ASHK-ja refuzon të zbatojë detyrimet ligjore sipas Kodit të Procedurës Administrative, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 107, pika 1, të Kushtetutës. Duke qenë se kërkuesi nuk ka pasur një përgjigje, në datën 09.03.2024 ai i është drejtuar sërish me kërkesë Kryetares së Kuvendit, në të cilën i kërkon informacion për veprimet e ndërmarra në lidhje me ankesën e tij të datës 12.02.2024.

3. Me shkresën nr. 1-10/1 prot., datë 11.03.2024, Kuvendi i është drejtuar ASHK-së, duke i bashkëlidhur kërkesën e kërkuesit dhe, gjithashtu, duke kërkuar vlerësimin dhe shqyrtimin brenda afatit ligjor të kërkesës së tij, me shënimin që në përfundim të shqyrtimit ASHK-ja të sqarojë edhe kërkuesin.

4. Në datën 30.04.2024 Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së, me shkresën nr. prot. 3916/1, datë 30.04.2024, i është drejtuar për trajtimin e rastit Drejtorisë Vendore të ASHK-së, duke vënë në dijeni edhe Kryetaren e Kuvendit, por njëkohësisht edhe kërkuesin. Kërkuesi, pasi ka vënë re parregullsi ligjore dhe interpretim jo të saktë në përmbajtje të shkresës, i është drejtuar sërish Kryetares së Kuvendit në datën 02.05.2024, duke i bërë të ditur këto parregullsi, për të cilën nuk ka pasur një përgjigje. Sërish në datën 20.05.2024 kërkuesi i është drejtuar Kryetares së Kuvendit dhe në referim të nenit 12 të ligjit nr. 8550/1999 e ka vënë në dijeni se nëpërmjet kërkesave i ka krijuar mundësinë Kryetares së Kuvendit të konstatojë shkeljet ligjore të kryera nga nëpunës të administratës. Edhe në lidhje me këtë kërkesë kërkuesi nuk ka pasur një përgjigje.

5. Në datën 16.08.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, me objekt shfuqizimin e nenit 5 të ligjit nr.8550/1999.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mbështetje të kërkesës së tij drejtuar Gjykatës, ka parashtruar sa vijon:

6.1. Për legjitimimin:

6.1.1. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, edhe pse nuk ka qenë pjesë e asnjë procesi gjyqësor, pasi dispozita e kundërshtuar cenon të drejtën e tij për t'u përfaqësuar nga deputetët, e cila është e garantuar nga nenet 70, pika 1, dhe 131 shkronja "a" e Kushtetutës. Ai nuk ka mjet tjetër në dispozicion për rivendosjen e së drejtës përveç kërkesës drejtuar Gjykatës.

Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi kërkesën në Gjykatë e ka paraqitur brenda afatit ligjor, duke qenë se shkresa e fundit drejtuar Kryetares së Kuvendit është e datës 20.05.2024.

6.2. Për themelin e pretendimeve:

6.2.1. Nëpërmjet mosveprimeve të Kryetares së Kuvendit, në zbatim të nenit 12, të ligjit nr. 8550/1999 kërkuesit i është cenuar e drejta e përfaqësimit nga deputeti i Kuvendit, sipas përcaktimeve në nenin 5 të ligjit nr. 8550/1999. Kjo dispozitë ka boshllëk ligjor për mënyrën se si deputetët përfaqësojnë popullin, pasi është totalisht formale dhe nuk parashikon se si një deputet përfaqëson popullin dhe zgjedhësit e tij, në rastin konkret, kërkuesin. Në këtë mënyrë është në kundërshtim me nenin 70, pika 1, të Kushtetutës. Pasoja negative që vjen nga kjo dispozitë është mospërfaqësimi nga deputeti dhe kjo pasojë rregullohet qartë nëse në nenin 5 të këtij ligji, deputetit i përcaktohen qartë detyrat e përfaqësimit të popullit të cilat konsistojnë në hapjen e zyrave për pritjen e popullit dhe zgjidhjen e problemeve që kanë zgjedhësit e tyre me organet publike, por edhe me detyra të tjera. Arsyeja pse kërkuesi i është drejtuar Kryetares së Kuvendit është sepse në referim të nenit 7, pika 1, të Rregullores së Kuvendit është Kryetarja që përfaqëson Kuvendin.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësit

7.Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) të subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën, është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Kjo dispozitë kushtetuese është zbrëthyer konkretisht në ligjin nr. 8577/2000, që i njeh individit të drejtën për të ushtruar ankim kushtetues individual për kundërshtimin e çdo akti që cenon të drejtat dhe liritë kushtetuese (neni 71), si dhe parashikon kriteret paraprake që duhet të përmbushen për paraqitjen e tij (neni 71/a).

8.Sipas Gjykatës, bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, kërkuësi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriteret: (i) legjitimitimi *ratione personae*, në kuptimin që individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) legjitimitimi *ratione temporis*, në kuptimin që individi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) legjitimitimi *ratione materiae*, në kuptimin që individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

9.Për qëllime të legjitimitimit, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, në rastin e pretendimeve për papajtueshmëri të ligjit me Kushtetutën, kërkuësi duhet të provojë se është viktimë e shkeljes dhe se zbatimi i dispozitave të ligjit të

kundërshtuar cenon interesat e tij, duke sjellë pasoja të drejtpërdrejta dhe reale. Kërkuesi mund të pretendojë se është viktimë e një shkeljeje nëse atij i kërkohet të modifikojë sjelljen e tij ose rrezikon të procedohet për mosrespektim të ligjit (*shih vendimin nr. 1, datë 25.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Kolegji vëren se kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e nenit 5 të ligjit nr. 8550/1999, i cili parashikon të drejtën e deputeti për t'u takuar periodikisht me zgjedhësit ose kur e kërkojnë ata dhe mënyrën e përfaqësimit të tyre, duke iu marrë mendime ose duke iu dhënë shpjegime për projektligje, amendamente, vendime, rezoluta apo deklarata që shqyrtohen dhe miratohen në Kuvend. Edhe pse kërkuesi e ka lidhur ankimin kushtetues individual me të drejtën për t'u përfaqësuar nga deputetët e Republikës së Shqipërisë të zgjedhur prej popullit, në thelb, problemi i tij i kundërdrejtohet organit publik, ASHK-së, në lidhje me pronën e tij. Në këtë mënyrë, mosveprimi i Kuvendit ndaj kërkesave të vazhdueshme të kërkuesit, në kushtet kur organi kompetent për çështjen e tij është ASHK-ja, nuk sjell asnjë pasojë negative në të drejtën e tij të pronës private, që është e drejta kushtetuese që ai ka synuar të mbrojë përmes ankimit drejtuar Kuvendit.

11. Neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës nuk parashikon të drejtën e paraqitjes së një *actio popularis* dhe nuk lejon që individët të kundërshtojnë një akt të pushtetit publik pa qenë të prekur drejtpërdrejt prej tij, pra vetëm sepse e konsiderojnë si të papajtueshëm me Kushtetutën. Në këtë kuptim, kërkuesi nuk mund t'i drejtohet kësaj Gjykate në mënyrë të drejtpërdrejtë për kundërshtimin e ligjit objekt kërkesë, por ai duhet të paraqesë një akt individual negativ (*ose ndalues*) të dalë në zbatim të këtij ligji, nga i cili t'i ketë ardhur një pasojë negative konkrete, që duhet ta kundërshtojë gjyqësisht bashkë me dispozitat ligjore që i konsideron të papajtueshme me Kushtetutën.

12. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuesi, duke mos arritur të provojë pasojat e drejtpërdrejta dhe reale në të drejtat e tij kushtetuese për shkak të përmbajtjes së dispozitës së kundërshtuar, nuk ka arritur të provojë se është viktimë e shkeljes, për rrjedhojë nuk legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, për sa kohë nuk provon interesin e drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Në kushtet kur kriteri paraprak për legjitimimin *ratione personae* nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

14. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.